



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY



Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: 30.05.2019 (e enjte) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raportimi i Komisionit për dhënjen e tokës Komunale në Shfrytëzim;
3. Aprovimi i planit aksional të Komunes për efqenc të energjisë (PAKEE);
4. Aprovimi i propozimit për percaktimin e automjetve të vjetra Komunale që janë jashtë përdorimit;
5. Informat rreth mos kycjes te të gjithë ujëjellësve egzistues në Komunen e Novobërdës në memorandumin e nënshkruar në mes të Komunës së Novobërdës dhe Kompanis Regjinale Hidromorava;
6. Informat rreth mos mirëmbajtjes dhe funksionalizimit te të gjithë sitemeve të ndriqimit publik egzistues në Komunen e Novobërdës;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 21.05.2019
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E NOVOBERDES - OPSTINA NOVO BRDO
DALESE - IZLAZNA

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Nr./Br. 01-262
Mbr/Dena 21.05.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 25.04.2019, duke filluar në orën 10:08.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Xhejlane Behluli, Predrag Stojkovic, përfaqësuesi i OSBE-es, përfaqësuesit e Kfor-it dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit njoftoj antarët e Kuvendit që nga KQZ-ja ka arritur vendim për zëvendësimin e antarëve të rinjë, filloj me prezentimin e zëvendësimit të dy antarëve të rinjë të Kuvendit nga partia e LDK-së, në vend të z.Xhevat Mehmetit është Jahi Zeqiri dhe në vend të z.Bajrush Ymeri është antar i ri z.Zymer Zymeri dhe nga këta dy antarë kërkoj të përsëritet dhënja e betimit të lexura nga Kryesuesi pas ti ata ripërsëritën.

Unë betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Novobërdës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi pasi lexoj betimin filloj me mbledhjen duke konstatuar korumin prezent janë 13 antarët të Kuvendit dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe tha se tani jemi edhe 15 antaër të Kuvendit Komunal dhe ju dëshiroj mirseardhje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të parë Janar-Mars 2019;
3. Aprovimi i Vendimit për formimin e komisionit për dhënje me qira afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;
4. Dhënja e peqlimit Eko Higjenes, për pagesen e participimit për mirëmbajtje të ambientiti me 1,6,8, Maj 2019;
5. Aprovimi i vendimit për formimin e KKS-së
6. Aprovimi i Statutit të QKMF-së Kufcë e Epërme;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Xhejlane Behluli pasi përshëndeti të pranishmit tha: nje herit uroj kolegte e rinjë anatrë nga radhet e LDK-së që janë bashkangjitur sot, ku fatëkeqësishtë ndaj tyre që 8 muj ju ka bërë një e padrejtë, kurse unë kam një kërkesë tjetër ka të bëjë me zavendësim të antarit të rinjë për Komitetin për Komunitete që i takon LDK-së te hudhet si rend dite, dhe ky vende është i rezervuar nga radhët e LDK-së, nëse duhet të propozoj qe nga sot une propozojë që të hudhët edhe si rendë dite, çështja tjetër zonj. Behluli kërkoj që pika e gjashtë të rendit të ditës të hiqet për arsye se ne kemi marr ankesa edhe nga banorët dhe puntorët qytetarë që punojn në QKMF në Novobërdës, ku jem të informuar që me ligjë është e drejt të egzistoj vetëm një QKMF-ë ku ajo vetem egziston e pse të egzistoj e dyta, andaj këkroj edhe nga antarët koleg ta votoj për teheqjen e kësaj pike nga rendi i ditës.

Kryesuesi tha: siç e kuptova të hudhet në votim për rendë dite plotësim i vendit të antarit të rinjë për Komunitete nga radhët e LDK-së, dhe çështja tjetër terheqja e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Pasi nuk patë diskutim tjetër Kryesuesi e hudhi në votim për përzgjedhjen e antarit të rinjë për komunitetet dhe me 15 vota për, asnjë kundër aprovohet propozimi për përzgjedhjen e antari të rinjë për komunitetet, më pastaj hudhi në votim terheqjen e pikës së gjashtë nga rendi i ditës Aprovimi i Statutit të QKMF-së Kufcë e Epërme 12 vota për dhe tri vota kundër (Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic dhe Jorgovanka Filic) terhiqet pika e gjashtë nga rendi i ditës.

Pasi nuk pati propozime tjera me 12 vota për 3 kunder (Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic dhe Jorgovanka Filic) aprovohet rendi i ditës me një pikë shtes për përzgjedhjen e antarit për komunitete dhe terheqjen e pikës së gjashtë.

Pika e parë: Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime me 14 vota për dhe 1 apstenim aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë: Aprovimi i Raportit Financiar tremujor të parë Janar-Mars 2019;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Serxhan Todorovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: shpresoj që me kohe e keni marr raportin financiar për tremujorin e parë Janar-Mars 2018, në pika të shkurta do ta prezentoj, të hyrat vetanake për muajin Janar, Shkurt Mars jan gjithsej 35,701.66€ ketu jan të hyrat e taksës toka, regjistrim vetura, te hyrat e komunës etj., e keni edhe ne tabel të precizuara. Mjetet e planifikuara per tremujorin e pare per vitin 2019 per Paga dhe Meditje kan qene te planifikuara ne vlerë prej 475,868.25€, kurse të shpenzuzra janë ne vlerë prej 473,103.41 €, ne perqindje eshte 99.40%, për mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vlerë prej 36,683.68€ për shpenzime komunale jane shpenzuar ne vlerë prej 20,890.16 €, për subvencione jane shpenzuar ne vlerë prej 550.00 €, për detaje tjera une besoj qe e keni ne table, nëse ka pyetje jam ketu për përgjigje dhe komente.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: uroj antarët e rinjë ju uroj punë dhe sukses dhe shpresojë që kuvendi tani do të jetë i plotë me këta antër të rinjë dhe sa i përkete pikës së rendi të ditës së këti Raporti financiar qysh në mbledhejn e kalur kemi kërkuar që Raporti të jete I qartë ku janë duke shkuar mjetet e Komunës ku diskutohet për shpenzime permbarimore ku jan 10.000€ dhe sa jan dhën përmbaruësit e sa ka shpenzuar Komuna nuk jeni ka e specifikoni situatën e qështjes së mjeteve tek përmbaruësi, nuk mundeni të thëni se komunë së Novobërdës ju kan marr 5.000€ për përmbarim, po ju vetem I preziconi shpenzime permbarimore, nuk e dim a ju kan marr 10.000€ Kompani a përmbaruesi a po 5,000€ kurse qështja e dytë ju e din që Kryetarit ju ka marr e drejta për mos shpenzimin e Buxhetit për suvencione pa vendim të Kuvendit, pra ju keni bërë shkelje për shpenzimin 550€ për përsona juridikë pa vendimin e kuvendit është shum e pa qartë, kurse shpenzime tjera ku keni shkruajtur shumën 766€ nuk e keni cekur se për çka janë shpenzuar shpenzuarë, ne kemi dhën edhe me heret vrejtte ju prap se prap po vazhdoni njetë, unë si antarë i Kuvendit kërkoj që mos ta përkrahni këtë raportë se nuk është real dhe nuk tregon realitetet.

Serxhan Todorovic tha: se është dashtë të ceket se EccoHihiena i ka marr këto mjete, kjo ka qen vitin e kalura por nuk kemi pas mjete ti paguaj ,se kemi pas shpenzim rryme,ujin taksa tjera e për këtë ka mbete borgji këtë vit se kemi pas një shum të vogel në vlerë 46.000.00€ nga shpenzimet komunale kshtu qe kemi pa të arsyshme të bejm pagesa e shpenzimeve të rrymës në shkolla dhe ambulanteve se sa shpenzimet e Eko Higienes edhe për kete na kan marr këto para në këtë vitë, kurse të subvencionet 550€ po jan ma shumë subvencone, kemi një fond për ushiqm pije dhe matriale tjera të gjitha nuk mujm ti cekim me emra p.sh prishja e gjeneratorit nuk kemi kod për pages nuk mujm ta shkrujam dhe shkruja shpenzime komunal ky është dallimi ose kur është pyetje top për shkolla nuk mujm ta shkruj top për shkoll por e shkrujam shpenzim komunal .

Xhejlan Behluli tha: drejtori nga ana ime merr falemenderim se është aktiv në të gjitha seancat e KPF-se edhe Kuvendi andaj ne si LDK e përkrahim këtë raportë.

Selatin Nuhiu pasi përshendeti të pranishmit tha: unë nuk e përkrahi raportin financiarë që vjen nga Drejtori i Financave, e kemi të hyrat të qirat publike i kemi 300€ kurs nga prona publike kemi 140€ kjo është një shumë e vogel e të hyrave,Komuna jonë ti mbledh vetem 140€ prej qiras publike kjo është skandaloze ne këtë raport nuk e përkrahim, kurse te shpenzimet e përmbaruesit privatë e keni bërë si shprehi këtë punë çdo here nga 10.000€ kjo nuk është rregull.

Serxhan Todorovic tha: kjo e hyrë është vetem për tre mujor, këto jan pagesa të taksave të regjistrimit une mundem të them 5.000€ po sjan aq jan të shkruar sa jan të paguara.

Avdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: i urojë mirseardhej dy asambleistave të rinjë, unë kam një shqetësim të participim nga shendetësia, ku është një shum 10€ une mendoj që shumica e qytetarëve obligohen një farë forme të kryen obligimin shendetësore dhe du ta di cila është arsy e kësaj shum kaq të vogel?, të hyrat nga konfiskim që është 278.40€ çfar konfiskim ka mundur të jetë ky?.

Serxhan Todorovic tha: te unë shkrun participim shëndetësi që është 278€ ,vetëm nëse është një gabim drejtë shkrimorë nuk po e di edhe pagesa 10€ gabim teknik ose përkthim tek ju pasi tek unë nuk është e shkrua.

Pasi nuk pati diskutime tjera u hudh në votim kjo pikë dhe me 7 vota për 8 kunder nuk u aprovua Raporti Financiar i tremujorit të parë Janar-Mars 2019.

Pika e tretë: Aprovimi i Vendimit për formimin e komisionit për dhënje me qira afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;

Kryesuesi tha: ne kemi marr kërkesën nga Drejtoria e Bujqësisë për formimin e komisionit për dhënje me qira afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës, pasi që prezantuesi i kësaj pike nuk është prezent kështu që mendoj se këtë pikë të rendit të ditës ta shtym për mbledhjen e ardhëshme.

Me 13 vot për 1 kundër dhe 1 apstenim u shty për mbledhjen e ardhshme kjo pikë.

Pika e katër: dhënja e peqlimit Eko Higienes,për pagesen e participimit për mirëmbajtje të ambientiti me 1,6,8, Maj 2019;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalen Naser Ibrahimit.

Naser Ibrahim pasi përshendeti të pranishmit tha: po e przantoj në pika të shkurta, para 10viteve kemi marrë vendim ne Kuvend edhe nga Kryetari i athershem z.Bajrush Ymerit që të bieht nje vendim nga Kuvendi që të bëhet inkasimi i mjetve në vler prej 1€ për vetur që hyn në Stanishor dhe teKalaja.Parat do të hyn në arkë edhe do të bëhet pagesa e taksës ATK-së dhe do të jetë në mënyrë të ligjëshme. Për arsye të mungesës së mjeteve bugjetore nga Komuna jon për mirmbajt të kësaj pjesë detyrohem të japim Komunës së Gjilanit, nese më përkrahni do të përfundoj punën me ekipin tim ashtu si është më së miri, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: po e them sinqerisht se Komuna e Novobërdës të vetmën mburrj e ka për tu këtë Kompani dhe sinqerisht ju përgëzoj për punë që bëni , përkrahjen time do ta kesh çdo herë.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: uroj suksese kolegëve të rinj dhe kam një pyetje për drejtorin e Eko Higenes, kërkoj se para se të fillon ky aktivitet le të mirren një pastrim gjeneral në rrugën Stanishor-Novobërdë ku në disa pjesë ka deponi ilegale.

Naser Ibrahim tha: une që 10 vite as një here nuk i kemi mbete borq asnjë qytetari. Unë me përgjegjësi të plotë e them se nuk ka keqpërdorim se në monetin që parat do të hyn arëk aty do të jep llogari dikush dhe mjetet do të perdoren vetëm për këtë ambient. Me vjen keq po deputeti në fjalë aty ku jeton ka mbetje të kafshëve të hudhura dhe ndoshta une kërkoj një iniciativë edhe të këshilltarëve Komunal dhe nga këshilli i fshatit që të merret ndonjë iniciativë.

Xhejlan Behluli tha: une e përkrahi këtë pikë dhe e përgezoi Naser Ibrahim, kolegj i nderuar une nuk pajtohem me ty se po i mallterton qytetarët se aty hyn edhe qytetarët e Gjilanit jo vetëm të Novobërdës edhe deri sa ne nuk kemi edukat që vetë të mbajmë pastër ambientin, po pajtohem me z. Ibrahim që të mirreni më fshatin e juaj merreni edhe ju një iniciativë për pastrim është edhe dita e tokës dhe mundeni me dal me pastru.

Avdyl Gashi tha: kërkoj të hyrat nga viti i kaluar sa kanë qënë ato, dhe sa është kapaciteti i puntorëve të angazhuar për këto ditë, për ndryshje çdo i de e mirë është e mirseardhur dhe kërkoj që në vendet e frekuentume të kenë edhe mbishkrimin të mos hudhen mbeturinat pse jo edhe inspekcioni ta bëjë punë e vetë që mos lejoj të hudhen mbeturinat.

Naser Ibrahim tha: në fshatin Stanishor në vitin 2018 janë mbledhë 1130€, kurse tek kalaja me 6 maj se me 8 maj nuk kemi dalë jan bërë 530€ total të gjitha kanë qënë 1660€. Ne në atë ditë angazhojmë 7 puntorë për inkasinë në të dy pjesët, ne parashohim edhe blerjen e qeseve, ushqimit dhe pijeve se paku angazhim ka 4 deri 5 ditë dhe na duhet ta pastorojmë terrenin prej Stanishorit deri në Bostan tek Kalaja.

Pasi nuk pati diskutime tjera kjo pikë u zotua njëzëri nga antarët e Kuvendit dhe u prurë ky:

V E N D I M

MIRATOHET kërkesa e Ndërmarrjes “Eko-Higjijena”, nga Gjilani, njësia Novobërdë, për pagesën e Participimit për mrimbajtje të ambijentit në teritorin e komunes, në lartësi prej 1 (një) eurove, edhe atë për ditët: 1,6,8.Maj.2019.

Pika e pestë: Aprovimi i vendimit për formimin e KKSBS-së;

Kryesuesi tha: çdo komunë ka obligim ta formojë KKSBS, në bazë të udhëzimit administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme e këta antarë të KKSBS-së duhet të jenë: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës për Komunitete, Komandant i Stacionit Policor, Përfaqësues i Komunitetit Musliman, Përfaqësues i Komunitetit Ortodoks, Përfaqësues i Komuniteteve Shqiptare, Përfaqësues i Komunitetit Serb, Përfaqësues i Komunitetit Rom, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete; Zyrtarë e Zyres për Barazi Gjinore, Zyrtar i Arsimit, Kryetar i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë; Përfaqësuesi i FSK-së, Kryetar i ekipes për veprim në sigurinë e komuniteteve, Sektori civil i emergjencës Komunale, Shefe e ZKKK, OJQ, Përfaqësues i mediave lokale, Përfaqësues i Bizneseve, Përfaqësues i komitetit lokal të sigurisë publike.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: kisha kërkuar nga Kuvendi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një arsye, në mandatin e kaluar kam qënë pjesë e këtij Komuniteti, në mandatin e kaluar 700€ na kanë mbete borqë ketu e kemi edhe Fadil Llapashtica një aktivist i pa rrugë është turp me jetu në Novobërdë me 700€ borqë. Unë kërkoi nga Drejtoria e Fiancave deri në seancën e radhës të na tregojnë nga buxhetet me i paguar obligimet që i ka, nuk e kanë dërguar drejtorin e arsimit jo kur ti tekton Kryetarin të qoj emra paushallë, por duhet dërguar emrin e drejtorit të arsimit dhe të tregohen kushtet për përfaqësuesit zyrtarë se kuvendi e voton propozimin, shiko kemi zyrtarin flamur Uka nëse është drejt le të del le të thotë që ky është drejtori, e jo ta përfaqësojë Drejtorin e Arsimit.

Bajrush Ymeri pasi përshendeti të pranishmit tha: njoftoj se edhe une kam qënë pjesë e këtij komuniteti dhe janë mbajtur disa takime të rregullta dhe fatëkeqsisht nuk janë paguar asnjë, në

rregullore Ministri i Financave e ka ndërpre financimin e zyrtarëve Komunal të cilët marrin pagë nga Institucioni, ndërsa e kanë pas të lejuar atyre që nuk marrin pagë nga Institucioni. Kurse për deri sa ju më herët folët për përmbaruesin që po i merr mjetet nga bugjeti z.Mehmeti dhe z.Llapashtica që keni qenë atarë të komunitetit për Siguri në Bashkësi e keni mundësi me paditë Komunën dhe mi fitu mjetet, të gjitha nënshkrimet vendime i keni që keni qenë pjesë e komunitetit kështu që e keni të drejtën ta shfrytëzoni.

Ramush Mehmeti tha: këtë fort mire e di dhe e kam ditë qysh në fillim, po që se do të shkojmë vetëm me forma të padijav, më e rrugës është ta dim nga bugjetë qëllim im është si antarë i Kuvendit kur so formuar që një vit e gjysem le të jete edhe një dy muj ta dim bugjeti se nga do ti paguajn të sigurohet bugjeti e jo të manipulohet me njerzë.

Dobrivoje Djordjevictha: të kyqëm në pike 10 nga një përfaqësuesve lokal, a ka për qëllim secilin përfaqësues fshati, se në çdo fshat egziston përfaqësim fshati a po nuk e kam kuptuar dhe qështja tjetër duhet pa tjetër të financohet ky komunitet a po më qenë interes i qytetarëve ku është e nevojshme të këtë këtë komunitet, me then të drejtën parat nuk janë që nuk na duhet edhe po edhe pajtohem me atë që tha z.Ramush dhe z.Bajrush i që duhet shikua edhe mundësitë bugjetore a ka, por nuk është prioritet pagesa po prioritet është siguria.

Bajrush Ymeri tha: mundem përshka të përkrthim të keqkuptohem sepse nuk i ke vendosur ndegjueset pasi e kemi perkthyesin, natyrisht që nuk duhet mi dhan prioritetë pagesës KKSBJ-a është një këshillë shumë i rëndësishëm që duhet ta themelojmë çdo Komunë dhe për pjesëmarrje në këtë komunitet është e përcaktuar me rregullore ligjerish, prandaj ketu ka paqartësi tek komuniteti i përfaqësuesit Shqiptar, kush është përfaqësuesi i Komunitetit Shqiptarë si e zgjedhim në përfaqësuesin shqiptarë ose përfaqësuesin e Komunitetit serb. Kryesuesi për Komunitete është dashtë me mbledhë nënshkrime për tu bërë kryesues i këti komuniteti ose edhe antarit njëjtë metodë është përdorë.

Dobrivoje Djordjevictha: nuk thash që nuk duhet të pagur ajo që duhet ,por thash se nuk është në rregull dhe na ka ardhë mundësi ta formoj këtë komunitet edhe mos të vij në plan të parë pagesa edhe nuk e shoh që është problem mos formimi pa u shiku financiarishtë.

Kryesuesi tha: do tja jap një sqarim sa i përket rregullores për formimin e këti këshilli në nenin 18 Kompensim në numer 1 për punën e tyre antarët e KKSBJ-së paguhet nga buxheti i Komunës përkatës, nën dy Kompensimi për antarët e KKSBJ-së për pjesëmarrje në takim,bëhet me shumë ekuivalente të antarëve të Komitetit për Politik dhe financa, sa është medija për KPF-ën do të jete edhe për KKSBJ-ën, edhe pse është obligim ky komunitet të formohet dhe është dashtë të shqyrtohet edhe me buxhet dhe të planifikohet menjëherë se si do të bëhet ,kurse that që në numr 10 nuk është e kuptueshme pjesa tek përfaqësuesit lokalë. Në Komunën tonë janë formuar dy përfaqësime një Kufce e Epër dhe Stanishorë dhe e dyta për Bostanin dhe Llabjan, janë formuar bashkëpunim me OSBE-en dhe Policin,pse në keto katër fshatra për arsye se kohëve të fundit janë më të dëmtuarit nga hajnia gjithashtu mundem edhe me OSBE-në sa i përket kësaj pike të bëjmë përzgjedhjen e këti përfaqësim në KKSBJ-në.

Jorgovanka Filipasi përshendeti të pranishmit dhe gjithashtu uroj kolegët e rinjë dhe ju uroj tha: deshta të kyqëm të dëmtimi i Kufcës, Stanishor, Bostan, nuk është e vërtetë janë të dëmtura të gjithë kurse sa i përket KKSBJ-së duhet pa tjetër sa ma shpejt ta formojmë dhe urgjentish do të na duhet.

Avdyll Gashi tha: është interesante se pse është vonuar përzgjedhja e këti komuniteti dhe pajtohem të gjithë që është dashtë të formohet mbrenda gjashtëmuajve të parë duke e pas parasysh vjedhejtë të cilat po ndodhin në Komunë tonë që janë bërë normale, kurs si pikë e rendit të ditës është prurja e vendimit por cilit vendim pasi që këtë listë kanë bërë dy persona, unë mendoj që kjo pikë duhet të shtyhet në mënyrë që të bëhet një analizë për antarët të cilët janë përcaktuar në këtë komitet, përveç tjerave duhet borgejtë të paguhet, nuk mundesh me funksionu deri sa i ke mbete borq dikujtë.Unë këkroj që lista

KKSB-së të mos bëher listë e militantëve të partive ,qytetarë kan nevoj të ken përfaqësuës për ofrimin e sigurisë.

Ramush Mhemeti tha: pasi që mu permendë emri prej dy kolegëve tha se po pajtohem plotësishtë se duhet ta formojmë dhe është duhur të formohet para një viti, nuk është von nëse shtyhët edhe një muaj po të sigurohet forma e pagesësë dhe ti marrmi emrat zyrtarë, nuk mundem të pajtohem pa e marr nga drejtoria e Arsimit se kush është përfaqësuës i prindërve e jo kujtdo që i teket të thot ky është përfaqësuësi i prindërve. Kryetari ka të drejtë me propozu e Kuvendi me votu.

Dobrivoje Djordjevic tha: KKSBB-ë duhet të formohet, tash për here të pare kemi popozim listën nëse nuk votohet për secilin emërë une jam kundë nuk e votojë KKSBB-ën edhe pse nuk i njo nuk dua ti votoj ,por kundërshtoj.

Bajrysh Ymeri tha: është e lehtë por duhet pasë vullnetë, përfaqësuësi i mediave qato medije aq sa janë e zgjedhin këshillin dhe ata e zgjedhin një përfaqësuës, këshilli i prindërve le takohen secila shkollë e ka nga një kryetar edhe nga një këshill të prindërve e mora si shembull gjithashtu OJQ-ët le të takohen e zgjedhin nje përfaqësuës e le ta dërgojn një përfaqësuës e lete është .

Kryesuesi tha: propozim i z.Ramush Mehemedi ishte që kjo pikë e rendit ditës të terhiqet, andaj e hudhi ne votim.

Me 9 vota për dhe 4 kundër shtyehte për mbledhjen e ardhshme kjo pik e rendit të ditës.

Pika e gjashtë: Pergjedhja e antarit të komitetit për komunitete.

Kryesuesi kerkon nga radhet e partisë së LDK-së që të dhënjë propozimin.

Xhejlane Behluli popozon Zymer Zymeri dhe tha: pasi qe jemi në mandatin e dyt dhe asnje rekomandim nuk ka ka ardh në KPF nga Komiteti për Komunitete për ndonjë kerkesë për shqyrtim në KPF-ë. Andaj ju kisha lut nëse jeni ka punoni dhe ka i mbani mbledhjetë e regullta veq sa për meditje atëhere e lajm krejt këtë punë, kisha dasht së paku në KPF-ën e ardhshme te kemi pika të rendit të ditës, ka pas për barazi gjinore që kan qen në ëeb faqë që me kan pëlqyrë por asnje rekomandim nuk ka ardhë në Kuvendë, andaj ju lutem te merrni seriozishtë të punojm për komunitetin.

Kryesuesi e hudhi në votim se kush është për z.Zymer Zymerin të jetë antarë i ri i Komunitetit për Komunitete me 15 vota për asnjë kundër u zgjodhë antari i ri për Komunitete z.Zymer Zymeri.

Ramush Mehmeti tha: se vet po keron që nuk ka rekomandim për KPF- nga Komuniteti për Komunitete dhe ne kemi një Kryetare për Komunitet dhe ajo përfaqësues është e LDK-së nënkryetare e nëndegës së LDK-së në, ju çdo send duhet me diskutu me to dhe është obligative me kërku pika në KPF une kam degjuar shum herë z.Bjarush ka kërkuar me ja rrit rrogën mu me ka ardhë befasi qysh një ish Kryetar i Komunes kur e din mire se kush i cakton rrogat, tani po e di arsyen se paska pas për qëllime për rrog se e pasa bërë të partis, ne të gjithë e dim se Kuvendi nuk ja rrit rrogen.

Xhejlane Behluli tha: ndoshta u keqkuptova se une e di mire se qfar përgjegjësi ka Shpresa Kqiku unë kerkova prej juve antarëve që jeni në Komunitete, fund të fundit ajo veq vete sun voton, ju duhet me votu e me përkrah dhe me pru rekomandime une po mendoj keshtu edhe mos te punohet vete sa për ato meditje.

Avdyl Gashi tha: koleg'ja më heret e pëmemdi Komunitetin për Komunitete ndoshta ka problem me Kryetrin i cilin përfaqëson Komunitetit ja ka problem me Kryesuesen e Komunitetit, ne po thojm që as Qevria nuk është tu funksionua vjen me formu KKSBB-ën nuk është Kryetari prezentë i cili bashkëpunon ngush me KKSBB-ën. KPF-në ka drejt edhe direkt me pru në Kuvendë kurse deri sa ju mendoni me pru antarë politikë të degës së pasjakut të cilët nuk jan të zot me udhëheq një mbledhej dhe me mbajt një proces të rregullt të mbledhjes atëher mbledhja për Komitete është shumë.

Kryesuesi kërkon që të përmbahemi pikave të rendit të ditës.

Bajrysh Ymeri tha: fillimishtë nuk është dasht të hym këtë qështje Ramushi hyr pa nevoj megjithat po e jap një sqarim Shpresa Kqiku Kryesuese e Komuniteteve per Komunitete nuk e kam zgjedhë unë, e kanë zgjedhë nja 500 nënshkrme që i ka mbeldhë ajo nëpër lokalitet. Kurse për zgjedhjen e antarsin në LDK-ë është e vertete e kam zgjedhe une dhe ligji ja lejon nuk mundet as kush me kontestu këtë punë, Xhejlanja

Procesverbali i Kuvendit

nuk e akuzoj askëndë, por vetem kërkojë prej komunitetit nëse kemi nja pik edhe une jam pjese ati komuniteti dhe nese kem pika të rendit të ditës ja vlen me diskutu në Kuvend dhe gjithonë kemi lënë takime para KPF-së po që se ka ndonjë pikë që me pas mundesin me pru në KPF-se dhe KK. Kur është qështja të pagesa unë kam kërkuar dhe do të kërkojë kushdo që do të jetë sepse Komunitetin për Komunitete e kam udhëheq edhe vete për nja 10 vite 2002-2006 dhe e di sa e vështirë ka qen puna e Kryesuesit për Komunitetet, Kryesuesi ka për obligim përpos mbledhjes së Komunitetev për Komunitete si dhe KPF-se si dhe K.K ati i bjen me ardh 3-4 herë me 50€ meditje nuk mundet as shpenzimet e veta mi mbulua, prandaj kam kërkuar që Kryesueses tju shtoj Kompenzimi, dhe kjo ka mundësi të bëhet, asnjë pengese ligjore nuk ka .

Selatin Nuhiutha: te qështja e Kryesueses ajo tani me nuk përfaqëson këtë komunitet, por përfaqëson degen e LDK-ës për Pasjakun ajo me nuk është e denjtë me udhëheqë atë Komunitet dhe propozoj që të shkarkohet prej asaj pozite. Nënkrjetari thot shpesh shkelsi i ligjit a kur vete dy her e ka shkel ligjin, ku është munduar nga ana e ti që të mundosj dhënja e betimit të dy antarëve të rinj jashtligjëshëm, ku asnjë vendë në Kosovë ska ndodhë kurse ky ka dasht të bëj diqka të jashtzakonshme kurse tani thot që nuk është Kryesuesja shkel e ligjit, kurse une them që kjo bash është shkelje e ligjit dhe popozoj që kjo pik të votohët ta shkarkojm atë dhe te mirrët vendim nga MAPL-ja. Kur kam pas z.Fadil Llapashtica antar të partisë kan shkuar nëpërmje OSBE-së dhe e kan detryaur me dhën dorheqje sepse nuk ja lejon ligji me qen Kryetar i ndonjë subjekti politikë ajo ka qenë shkelje andaj edhe kjo është shkelje dhe popozoj ta hedhim ne votim dhe ta shkarkojm .

Jorgovanka Filic tha: Shpresen z.Selatin don ta largoj, une nuk e largoj po do ta perkrahi dhe te gjith koleget edhe une si zavendes Kryesuese nese thojn dhe kerkojn diçka per komunitet une jam afer ketu dhe jam e gatshem tju ndihojm si dhe do ta perkrahi dhe mbaj shpresen dhe nuk e nderroj .

Bajrush Ymeri tha: z.Selatin ti qysh ke fillu nuk është rregull se ti je tani i ri antarë po ne kemi diku nja 10 a 20 vite përvoj si antarë i Kuvendi dhe nëpër pozita, kur të thuash Kryesuesja e Komunitetit nuk ka drejtë me qen e partis duhet të bazohesh në ligj, kurse e dyta kur thuash që une kam bër shkelje ligjit që kam kërkuar dhënjen e betimit kam kërkuar se ka qenë e drejtë e imja dhe e drejta fitoj më ne fund, ti zotni para një muaji nuk ja ke lejuar këti antari po që sot ky u zgjodhë, nuk ja ke lejuar një nënshkrim tendin që është dashtë me ja dhën për kolegen tënd me përkrah për antarë të Kuvendit aq ligështi të fort ke treguar sa që nuk matet me kurgjo, por është qështje e jotja ,kurse sa i perkete Fadil Llapashticës aty shkrun shumë kjart në ligj, prandaj gjej në ligj që Shpresa nuk duhet me qenë ne e nderrojm, por nuk shkrun askund edhe ti nuk e ke zgjedh po e kan zgjedhe 450 a 500 nenshkrime nuk e di sakt ata e kan votu.

Ramush Mhemeti tha: realisht Kuvendi e ka votu ju e din mire Bajrush qe ka qen nje mashkull që ka pas vota më shum dhe Shpresa ka kaluar që ka qenë e kërkuar femer, kështu që ne nuk po bejm shkelje ligjit .

Kryesuesi nderpreti debatin dhe kaloi në piken tjetër.

Pika e shtatë: të ndryshme.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiutha: kerkoj fjal replik ku thot Bajrysh Ymeri kerkon ta kontesoj emrin tim ne KQZ çfar ka mendu ky njeri, dhe thu që me në fund e drejta fitoj jo ti nuk fitove po fitoj Hashim Thaqi që i qërtifikoj KQZ .

Bajrysh Ymeri tha: te lutem të përmbahësh e jo te me folesh me fjal të huaj sepse kurgjo nuk është kontestuese nese une kërkojë, për arsy se ju nuk keni qen ne gjendja të na përkrahni këta dy antarë me dhënë betimin me heret, vetem me dhënë qatë mundësi Ministria ndoshta e kish kontestuar.

Pasi nuk pat diskutime tjera zv.Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje. Mbledhja përfundoi në ora 11:27.

Arbenita Llapashtica

Procesmbajtëse

per H. Llapashtica



Nebojsa Arsic

Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic